




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: "SYRI" SH.P.K.

NUI: 810232520

Pronari: Zeqir HAXHIJA

OSHMA: TV SYRI VISION

Adresa: Rr/Sadik Pozhegu Nr.28, Gjakovë

Emri i Biznesit: "SYRI" SH.P.K.

NUI: 810232520


Kandidati për pronar: Adnan KRASNIQI

OSHMA: TV SYRI VISION

Adresa: Rr/Sadik Pozhegu Nr.28, Gjakovë

VENDIM

për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik, të TV Syri Vision, me seli në Komunën e Gjakovës



Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. TV Syri është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale me mbulim regional, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin tokësor analog të programeve televizive, me seli në Gjakovë.
3. Më datën 13 prill 2021, TV Syri Vision ka dorëzuar në zyrën e KPM-së një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik dhe bartjen e licences së TV Syri Vision nga z. Zeqir Haxhija tek z. Adnan Krasniqi, në kuadër të biznesit të njëjtë në të cilin është lëshuar licenca e TV Syri Vision - "SYRI" SH.P.K. me Numër Unik Identifikues (NUI) 810232520.

Arsyvetim

4. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së".
5. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së"

6. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: “KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”
7. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të TV Syri Vision ka shprehur gatishmëri që, ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
8. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka paraparë investime në teknologjinë e transmetimit të TV Syri Vision dhe angazhimin e stafit profesional, ndërsa sa i përket qëndrueshmërisë financiare kandidati për pronar ka bashkangjitur dëshmi nga institucionet financiare.
9. Komisioni konstaton se, paraprakisht TV Syri Vision ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM-së.
10. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare si dhe zotimet për angazhimin e stafit profesional, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së TV Syri Vision është në interes të publikut.
11. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

12. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 29 korrik 2021, merr vendim për ndryshimin e pronësisë, respektivisht ndryshimin e pronarit si person fizik dhe bartjen e licences së TV Syri Vision nga z. Zeqir Haxhija tek z. Adnan Krasniqi, në kuadër të biznesit të njëjtë në të cilin është lëshuar licenca e TV Syri Vision - “SYRI” SH.P.K. me Numër Unik Identifikues (NUI) 810232520.
13. Përveç ndryshimit të pronësisë dhe bartjes së licencës të TV Syri Vision nuk do të ketë ndryshime në pjesët tjera të Licencës, si Pjesës II – Parametrave Teknik, III – Formatit të Programit dhe IV – Zonës së Mbulimit.
14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



29.07.2021
datë